



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "EMF Creative" Sh.p.k.
Numri Unik Identifikues: 810843111
Pronar: Milot Llaloshi,
OSHMA: PREMIER SONGS
Adresa: Rr/UI/Str.Nazim Gafurri nr. 56.Prishtinë



VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së OSHMA përmes OSH “Premier Songs”, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHMA “Premier songs” është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audiovizuale, me seli në Prishtinë. KPM, me datën 26 dhjetor 2014, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA “Premier songs”.
3. Më datën 10 korrik 2023, pronari, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e KPM-së për OSHMA përmes OSH “Premier Songs”

Arsyetimi

4. Heqja dorë nga licenca e KPM-së për ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale është rregulluar me Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2021/01), respektivisht nenin 19, paragrafi 1 i cili përcakton:

“Të licencuarit mund të heqin dorë në çdo kohë nga licenca e tyre, duke paraqitur kërkesë zyrtare në KPM”.

5. Ndërsa, paragrafët 2 dhe 3 të nenit 19, të rregullores në fjalë përcaktojnë:

“ 2. KPM varësisht nga arsyetimi do të merr vendim për ndërprerje të licencës, ndërsa obligimet ndaj tarifës për licencë dhe apo gjobave eventuale të të licencuarit ndaj KPM-së mbesin të obligueshme deri në datën e dorëzimit të kërkesës së heqjes dorë, të cilat do të shlyhen në pajtim me legjislacionin në fuqi”

“ 3. Tarifa vjetore e licencës për vitin në të cilin është bërë kërkesa për heqje dorë nga licenca e KPM-së do të paguhet e plotë, pa mundësi të kthimit të një pjese të saj”

6. Duke u bazuar në Nenin 19 të Rregullores KPM-2021/01 si dhe njoftimin e pronarit, për heqje dorë nga licenca e KPM-së në mënyrë vullnetare, Komisioni vlerëson se, ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së OSHMA përmes OSH “ Premier Songs”

Vendim

7. Komisioni në takimin e datër 17 korrik 2023 vendosë vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës të OSHMA përmes OSH “ Premier Songs”, sipas njoftimit me shkrim për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së.

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



17.07.2023

datë